

THIRRJE PËR OFERTË

Zhvillimi i platformës nëpërmjet sistemit GIS për hapësirat publike gjelbëruese në Prizren

Programi për të drejtat e njeriut, "HUMAN RIGHTIVISM", i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida), ka për qëllim që nëpërmjet shoqërisë civile të përmirësoj të drejtat e njeriut, që janë të natyrshme, origjinale dhe të bazuara në interes të grupit, përmes këtyre tri komponentëve: 1) Të drejtat e njeriut dhe aktivizimi arsimor; 2) Dokumentimi; monitorimi (watchdog) dhe qasja strategjike dhe 3) Të drejtat mjedisore.

EC Ma Ndryshe është njëra nga organizatat përfituese të këtij programi, në kuadër të të cilit shpall këtë thirrje përmes së cilës fton ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për ***"Zhvillimi i platformës nëpërmjet sistemit GIS për hapësirat publike gjelbëruese në Prizren"***

Zhvillimi i platformës nëpërmjet sistemit GIS për hapësirat publike gjelbëruese në Prizren ka për qëllim identifikimin dhe dokumentimin e hapësirave publike gjelbëruese, drunjët, mobilarin urbane, cilësinë e ajrit dhe matjet e qarkullimit të trafikut të veturave. Platforma do të shërbejë si një baze të dhënash për karakteristikat e rëndësishme të hapësirave publike të qytetit të Prizrenit. Kjo platformë do të jetë pikë referuese për të gjitha institucionet dhe përfaqësuesit e komunës së Prizrenit, organizatat që merren me mjedis, mediat dhe qytetarët e Prizrenit.

Zhvillimi i platformës duhet të përmbajë të dhëna nga terreni dhe analizë të gjendjes hapësinore të një zone të caktuar të qytetit të Prizrenit me të dhënat për hapësirat publike gjelbëruese, gjelbërimin (drunjët e ulët dhe të lartë), mobilarin urban, matjet e qarkullimit të trafikut të veturave dhe cilësinë e ajrit. Në platformë duhet të jenë të dhënat mbi hartën e qytetit me mundësi të filtrimit përmes filterëve të ndryshëm që tregojnë karakteristikat e secilës pikë të cekur më lart në databazë ashtu që të gjithë përdoruesit të ketë lehtësi në qasje në informacione dhe të dhëna

Kriteret për ofertim:

- Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim:
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit/ OJQ-së, Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSH-së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së),
- Për ekspertet/grupet e ekspertëve dërgohen vetëm CV-të e personave përgjegjës;

- Ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet, OJQ-të që kanë portfolio (projekte të realizuara të kësaj natyre) rekomandohet (nuk është obligative) ti bashkangjesin në ofertë;
- Çmimi duhet të përfshijë koston profesionale, punën në terren dhe ato të transportit;
- Pala ofertuese duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe;

Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyrat e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ose në mënyrë elektronike në info@ecmandryshe.org deri më **14 Mars 2022, ora 16:00** me shënim: ***Zhvillimi i platformës nëpërmjet sistemit GIS për hapësirat publike gjelbëruese në Prizren*** .

Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Për pyetje shtesë rreth kësaj thirrjeje mund të na kontaktoni në: info@ecmandryshe.org deri më **10 Mars 2022**.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente(dëshmi) shtesë nga ekspertet/ grupi i ekspertëve, kompanitë/konsorciumet, nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare.

Vetëm ekspertët/grupi i ekspertëve, kompanitë/konsorciumet fitues do të informohen/kontaktohen.